REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

MBROJTJA E PYJEVE NGA ZJARRI

Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor



Ky plan masash është mbështetur në Manualin për Mbrojtjen e Pyjeve nga Zjarri i përgatitur nga AKP-Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe CNVP-Bashkojmë Vlerat e Natyrës me Njerëzit, Tiranë 2024.

Bashkia Maliq , 2026

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Përmbajtja

1. **Hyrje** 3
2. **Shkaqet e shfaqjes së zjarreve në Pyje/Kullota.** 5
3. **Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota.** 7
4. **Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ne pyje.** 11
5. **Masat mbrojtëse kundër zjarreve të pyjeve/kullotave.** 12

5.1. Masat parandaluese 12

5.2 Masat përgatitore 14

5.2.1 Zbulimi i zjarrit shpejt (në kohë) - vrojtimi dhe njoftimi/sinjalizimi 15

5.2.2 Përcjellja e informatave 17

5.2.3 Organizmi i transportit për zjarrfikësit 17

5.2.4 Furnizimi me vegla dhe pajisje të duhura 17

5.2.5 Rekrutimi dhe trajnimi i zjarrfikësve 18

5.2.6 Ndërtimi i brezave ndarës të lëndës djegëse dhe korridoreve për luftimin e zjarreve 18

5.2.7 Harta e lëndës djegëse dhe reduktimi i lëndës djegëse 19

5.2.8 Përcaktimi i rrezikut të zjarrit 19

5.2.9 Plani vjetor i masave për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve e kullotave 21

5.3 Masat direkte të lokalizimit dhe shuarjes 21

6. **Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor** 26

6.1. Zonat me risk në Bashkinë Maliq dhe historiku i zjarreve 26

6.2. Struktura e Bashkisë Maliq për organizimin e skuadrave për shuarjen e zjarreve 29

1. Hyrje

Ky plan masash është përgatitur në zbatim të:

- Ligjit Nr,57/2020 "*Për Pyjet*",
- Ligjit 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor"i ndryshuar,
- Ligji nr. 10120, datë 23.4.2009 *"Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore"* i ndryshuar,
- Ligji nr. 45, datë 18.7.2019 *"për Mbrojtjen Civile"*,
- Ligj Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,
- Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF 2023- 2030) Datë: 31 gusht 2022,
- VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 "Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive",
- VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile",
- VKM nr. 747, datë 20.11.2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile",
- VKM nr. 531, datë 01.08.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile",
- Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore",

Bashkia Maliq përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Libonik, Gorë, Moglicë, Vreshtas, Pirg, Pojan. Bashkia Maliq është përgjegjëse për administrimit e fondit pyjor dhe kullosor sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkia e Maliqit sipas planeve të reja të menaxhimit ka një fond prej 32536.55 ha pyje dhe kullota , të ndara sipas përdorimit të territorit :

Kategoria	Sipërfaqia (ha)
Pyll	20270.39
Kullota / Livadhe	4540.519
Shkurre	6660.67
Eroduar / Erozion / Gurore	1013.53
Urbane / Jo Pyjore	32.17
Ujore	19.24

Tabela më poshtë jep të dhënat mbi këto sipërfaqe për secilën Ekonomi Pyjore të Bashkisë Maliq sipas planeve të menaxhimit të hartuar në vitin 2021:

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Nr.	Ekonomia Pyjore	Sip. ha	Pyje dhe shkurre / ha	Kullota dhe livadhe / ha
1	EP Maliq - Lozhan	5875.58	5540.10	220.69
2	EP Mesmal	3053.64	2519.17	529.39
3	EP Moglicë	6311.63	4590.3	1195.66
4	EP Pirg – Moçan	6239	5861.41	158.69
5	EP Bofje Dushar	3902.65	3281.34	460.28
6	EP Zëmblak-Mali i Thatë	2713.87	1783.12	923.27
7	EP Strelcë	4440.18	3355.62	1052.52
	Totale	**32536.55**	**26886.06**	**4540.5**

Harta e Pyje/kullota Bashkia Maliq sipas Ekonomive Pyjore dhe zonat kryesore ku ka pasur raste të rënies së zjarrit në pyje/kullota.



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Sipërfaqja e madhe e kësaj pasurie , rëndësia e saj por edhe shpërndarja e madhe bën që ti kushtohet një rëndësi e madhe administrimit dhe mbrojtjes nga zjarri.

Zjarret në pyje në pesë vitet e fundit paraqesin një problem serioz për pyjet në Bashkinë Maliq pavarësisht se situata ka qenë e menaxhueshme dhe në kohë mjaft të shpejtë duke ndaluar përhapjen pa shkaktuar dëme të mëdha.

Për këtë flasin vetë shifrat të cilat për periudhën 2021-2025 rezultojnë të jenë djegur rreth **185 ha** pyje e kullota por 90 % e kësaj sipërfaqe të djegur është nga një rast i vetëm, rast i cili ka qenë zjarri më serioz në këto 10 vitet e fundit në fondin pyjor – kullosor të Bashkisë Maliq. Dëmet e këtyre zjarreve kapin vlera të konsiderueshme, kosto këto që përfshijnë dëmet direkt si edhe kostot për të riparuar pasojat e zjarreve. Përveç dëmit shumë të madh ekonomik, qe mund të shprehet në të holla, dëmi i shkaktuar në biocenozën e pyllit , pra dëmi ekologjik, është gjithashtu shumë i madh dhe nuk mund të shprehet dot në mënyrë financiare.

2. Shkaqet e shfaqjes së zjarreve në Pyje/Kullota.

Njohuritë dhe përvoja jonë e deritanishme tregon se në shumicën e rasteve shkaku i zjarrit në pyje dhe kullota (direkt ose indirekt), **është njerëzor.**

Goditja nga rrufeja dhe vetëdjegia nuk konsiderohen apo janë shumë të rralla si shkaqe për zjarret e shkaktuara në pyjeve.

Njerëzit shkaktojnë zjarre në pyje si shkak i pakujdesisë, injorancës, lakmisë, diversionit, sëmundjes se zjarrvënies (piromanisë) e të tjera.

- ***Në kategorinë e zjarreve të shkaktuara nga pakujdesia dhe injoranca hyjnë zjarret e shkaktuara nga:***
  a. Punëtorët, kur janë duke kryer operacione të caktuara pyjore apo bujqësore në pyje apo sipërfaqe pyjore/kullosore. Zjarre të tilla zakonisht ndodhin në pranverën e hershme (puna në terren, pyllëzim) kur bari i vitit të kaluar është tharë dhe bimësia tjetër nuk ka filluar akoma ciklin e vegjetacionit.

Vendosja e zjarrit në hamullore është rasti më i zakonshëm i zjarrit të shkaktuar nga pakujdesia dhe kjo mënyrë e pastrimit të bimëve të padëshiruara nga fermeri, është e ndaluar.

b. Mbledhësit e frutave të pyjeve dhe bimëve mjekësore, gjahtarët dhe peshkatarët, blegtorët dhe turistët.
c. Zjarret e shkaktuara nga objektet në pyje (hekurudha dhe rruga për transport publik, linjat e transmetimit të tensionit të lartë etj.).

Numri i zjarreve në zonat e hapura është i madh për shkak të mungesës së masave parandaluese në kohë (pastrimit të zonës përreth, skajeve/anëve të rrugëve dhe të ngjashme me këto) rreth objekteve të përmendura.

- ***Në kategorinë e zjarreve shkaktuar nga lakmia dhe diversioni janë zjarret e shkaktuara në pyje me qëllim të caktuar:***
  a. Me qëllim shtimin e tokave bujqësore apo kullosore, urbane, njerëzit i djegin pyjet pa marrë parasysh pasojat e një akti të tillë.
  b. Në kushte të përshtatshme atmosferike, disa njerëz qëllimisht u vënë zjarrin sipërfaqeve pyjore, si hakmarrje ndaj pylltarëve.

c. Pyjeve gjithashtu mund t'iu vihet zjarri qëllimisht për arsye politike, p.sh.: për të destabilizuar

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

vendin me një numër të madh të zjarreve në pyje e kullota.

- ***Kategoria e zjarreve të shkaktuara nga mungesa e ndërgjegjësimit dhe sëmundja e zjarrvënies përfshin:***
  a. Zjarret e shkaktuara nga lojërat e fëmijëve me zjarrin (fëmijët janë të pavetëdijshëm që lojëra të tilla mund të shkaktojnë zjarre dhe të jenë fatale për ta).
  b. Zjarret e shkaktuara nga njerëzit e sëmurë "piromanët" për të cilët vënia e zjarrit objekteve ose sipërfaqeve me pyje dhe shikimi (parja) e tyre duke u djegur *"u jep atyre një kënaqësi të madhe"*.
- ***Zjarret që ndodhin gjatë luftës*** konsiderohen një kategori e ndarë. Këto zjarre nuk klasifikohen në asnjërën nga kategoritë e listuara më lart.



a) Hedhja e një cigareje përfundon si shkak i zjarrit



b) lojërat e fëmijëve si shkak i zjarreve



Djegia e kashtës (hamullores) si shkak i zjarrit

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

3. Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota.

Në bazë të përvojave ndër vite, njihen apo klasifikojmë 4 lloje të zjarreve në pyje dhe kullota, me të cilat duhet të njihemi paraprakisht dhe të jepen sqarimet dhe shpjegimet përkatëse nga trajnerët apo menaxherët e zjarreve në pyje dhe kullota.
Cilat janë ato?
Zjarrfikësit e shuarjes së zjarreve, punonjësit në pyje, por dhe vullnetarët, duhet të dinë karakteristikat e zjarreve në pyje para se të përpiqen për t'i lokalizuar dhe shuar ato. Rëndësia e njohjes së tyre qëndron në faktin e menaxhimit më të mirë të burimeve dhe përpjekjeve për të lokalizuar dhe shuar zjarrin.
Kjo, gjithashtu, do të ndihmojë zjarrfikësit për të përgatitur dhe për të mbrojtur më mirë veten nga një aksident i mundshëm. Pas shpjegimit të tyre, çdo pjesëmarrës mund të japë shembuj nga eksperienca e tij/saj (nëse ata kanë).
Ekzistojnë disa klasifikime të zjarreve në pyje/kullota, por më i shpeshtë është klasifikimi sipas zonës së djegies aktive:

a) **Zjarri nëntokësor;**
b) **Zjarri sipërfaqësor;**
c) **Zjarri i kurorave;**
d) **Zjarri i kombinuar.**

a) *Zjarri nëntokësor*

Karakteristikë e këtij lloj zjarri është se procesi i djegies ndodh nën shtresat e trasha të lëgushës, myshkut, gjetheve të pakalbura etj. Zjarri përhapet gradualisht dhe tymi i çliruar mbush hapësirat midis materialeve djegëse dhe del në sipërfaqe pa u vënë re, me përjashtim të rasteve kur takon rrënjët e ndonjë cungu, të cilët veprojnë si oxhak dhe tymi del në sipërfaqe më intesivisht.
Vënia re e këtyre zjarreve është e vështirë. Si rezultat, zjarre të tilla shpesh nënvlerësohen, por ato vërehen nga fakti që bimësia mbi këto sipërfaqe thahet.

b) *Zjarri sipërfaqësor*

Zjarri sipërfaqësor konsiderohet një zjarr gjatë së cilit ekziston djegia aktive në sipërfaqen e tokës, p.sh.: bimësia e tokës është duke u djegur apo gjethet me degë të vogla që kanë rënë, boçet etj. Ky është një ndër zjarret më të shpeshtë dhe shkakton tipe të tjera zjarresh (zjarret e kombinuara apo ato të kurorave të drurëve).
Në varësi nga konfiguracioni i terrenit dhe shpërndarja e lëndës djegëse, ky lloj zjarri përhapet shumë shpejt. Përbën problem serioz për sa i takon lokalizimit dhe shuarjes së tij.

Bazuar në kushtet e përmendura më lart dhe në mungesën apo prezencën e erës, flakët në këtë lloj zjarri mund të arrijnë lartësinë deri në 1.5 m dhe më shumë. Në rrafshina, djegia intensive zakonisht ndodh në skaje të zjarrit, ndërsa në zona malore djegia ndodh në ballë të zjarrit. Shpejtësia me të cilën përhapet ky zjarr (pa erë të fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026



a) Zjarri nëntokësor



b) Zjarri sipërfaqësor

c) ***Zjarri i kurorave (të drurëve)***

Zjarri në kurorat e drurëve është lloji i zjarrit gjatë të cilit ndodh djegia në kurorat e drurëve. Në shumicën e rasteve, zjarri është në trungje individuale, por ka edhe raste kur një zonë më e madhe është në zjarr. Zjarri, ndonjëherë në tokat kënetore/ moçalore ose në rastin me erëra shumë të forta, thjesht "fluturon" përmes kurorave të drurëve pa zbritur në tokë.

Në raste të tilla, për shkak të shpejtësisë së lartë, djegie të plotë pësojnë gjethet, kurse degët mbeten vetëm "gjysmë të djegura". Ky lloj i zjarrit mund të ndodhë, gjithashtu, si një fazë e një zjarri të kombinuar kur vetëm kurorat e drurëve janë djegur. Për shkak të faktit se intensiteti i djegies është në degët e pasura me gjethe (për pasojë edhe lagështia është më e lartë), ka më shumë tym dhe flakë. Shpejtësia e përhapjes është e lartë dhe ndodh si hedhje eksplozivi - flakë më e gjatë. Drurët me kurora që takohen ose janë afër njëri-tjetrit rrisin probabilitetin e përhapjes së zjarrit përmes kurorave.

Në pyjet kur zjarri është një rrezik i lartë, duhet të hiqen/priten mjaftueshëm drurë në mënyrë që **dy kurora drurësh** të jenë të paktën 3 metra larg nga njëra-tjetra. Në shpatet më të thepisura se 20% pjerrësi, hapësira midis kurorave duhet të jetë më e madhe.

Drurët bashkëshoqërues (që rriten nën kurorat e grumbullit parësor) sigurojnë një "shkallë, mundësi kalimi" për zjarrin, për të lëvizur nga toka në kurorat e drurëve më të mëdhenj. Drurët më të vegjël formojnë një lloj shkalle për konfigurimin, i cili kontribuon që zjarri të përhapet në kurorat e drurëve më të mëdhenj.



a) Zjarri në kurorat e drurëve

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026



b) Zjarri i kombinuar

d) ***Zjarri i kombinuar***

Zjarret gjatë së cilëve lënda djegëse tokësore dhe kurorat e drurëve digjen në të njëjtën kohë quhet zjarr i kombinuar. Për shkak të kësaj veçorie, këto zjarre janë më të vështirat për t'u lokalizuar dhe shuar.

Shpejtësia e përhapjes së këtyre zjarreve varet nga konfiguracioni i terrenit, llojet dhe shpërndarja (vertikale dhe horizontale) e lëndës djegës. Gjithashtu, shpejtësia e erës luan një rol vendimtar në përhapjen e zjarrit që mund të arrijë deri në 10 km/h.

Përhapja e zjarrit të kombinuar kalon në tri faza: **faza përgatitore, kërcimi i zjarrit dhe faza qetësuese.**

Faza përgatitore: është kur zjarri ka arritur në kurorat e drurëve dhe than dhe djeg gjethet. Gjatë kësaj djegieje, nxehtësia e çliruar akumulohet në kurorat e drurëve dhe formon një rrymë nxehtësie mbi kurorat e tyre. Kjo rrymë përbëhet nga ajri i nxehtë, tymi dhe pjesëzat e tjera (pjesëzat e drunjve pjesërisht të djegura, shkëndijat, copat e vogla të gjetheve etj). Kjo nxehtësi e akumuluar në kurorat e trungjeve dhe rrymat qarkulluese rrezatojnë dhe, në këtë mënyrë, ngrohin dhe thajnë kurorat e drurëve në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Kur një sasi e mjaftueshme e lëndëve djegëse të gazta të avulluara është akumuluar në kurorat e drurëve në zonën përpara zjarrit, në një pikë të caktuar në rast të djegies intensive përballë zjarrit, gazet në kurorat e drurëve ndizen në zonën përballë zjarrit.

Kjo ndezje mund të ndodhë në distanca të ndryshme nga pjesa e përparme e zjarrit dhe quhet **kërcim i zjarrit**. Kjo është faza e dytë e përhapjes së zjarrit dhe kërcimi mund të ndodhë, madje, edhe në disa dhjetëra metra para pjesës së përparme të zjarrit.

Kjo shkakton një tjetër zjarr në zonën para pjesës së përparme të zjarrit.

Pastaj vjen një **fazë qetësuese**; gjatë kësaj faze zjarri "kryesor" lëviz drejt zjarrit të ri, i cili zbret nga ***kurora e trungjeve*** në tokë. Në këto momente kemi përshtypjen se zjarri është qetësuar, por në fakt është faza e parë përgatitore e një kërcimi të ri të zjarrit që është duke ndodhur këtu tashmë.

Zjarrfikësit duhet të njohin mirë këtë përhapje të zjarrit në mënyrë që t'i shmangen rrezikut të të zënit midis dy zjarreve kur ka kërcim të zjarrit dhe kur jeta e tyre vihet ne rrezik.

Në rast të zjarreve tokësore apo të kombinuara, pjesët vijuese mund të klasifikohen në vendndodhjen e zjarrit: pjesa e prapme e zjarrit, pjesët anësore të zjarrit, pjesët e gjurmëve apo rrezeve, hendeqet e zjarrit, pjesa e përparme e zjarrit dhe shkëndijat (zjarret e reja).

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026



Fig. Pjesët përbërëse të zjarrit

• Pjesa e prapme e zjarrit është vendi i zjarrit ku djegia ka intensitetin më të ulët dhe shpejtësinë më të ngadaltë të përhapjes.

• Pjesa anësore e zjarrit është vija e djegies që ka intensitetin më të fortë dhe shpejtësinë e përhapjes më të madhe krahasuar me pjesën e prapme të zjarrit, por nuk është drejtimi kryesor në të cilin përhapet zjarri.

• Gishtat apo rrezet e zjarrit janë pjesë të përparme të zjarrit. Ato formohen si rezultat i faktit që pjesa e përparme e zjarrit arrin në zonat ku nuk ka lëndë djegëse apo ku lënda djegëse digjet me intensitet më të ulët. Rrezet më vonë mund të bashkohen me pjesën e përparme të zjarrit duke formuar një linjë apo mund të vazhdojnë në një drejtim tjetër duke krijuar kështu linja të reja përpara zjarrit.

• Zonat midis rrezeve të zjarrit quhen xhepa të zjarrit. Ato janë tepër të rrezikshme, pasi zjarrfikësit apo njerëz të tjerë mund të zihen aty, pa qenë në dijeni që janë të rrethuar nga zjarri.

• Pjesa e përparme e zjarrit është linja e djegies më intensive. Ai është drejtimi kryesor i zjarrit.

• Ishulli apo zjarri i ri është vend i nxehtë i ri, në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Mund të krijohet nga një kërcim zjarri, boçe e djegur, gjethe e djegur etj.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

4. Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ne pyje.

Më të rëndësishmit janë.

- **Lloji i bimësisë**
- **Topografia**
- **Stina vjetore**
- **Karakteristikat klimaterike**
- **Komunikacioni**

Lloji i bimësisë është një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e rrezikut nga zjarret. Kështu pyjet halorë ndizen më lehtë se ato gjetherënës. Drurët dritëdashës janë më të rrezikuar kjo për shkak se përbërja e pyllit me këto lloje drurësh është më i rrallë. Kështu llojet e bimëve që ndizen lehtë dhe e mbështesin fuqimisht djegien quhen specie bimore " profibe" (pishë , bredh, etj).

Topografia apo relievi i terrenit , së bashku me llojin e tokës luan një rol të rëndësishëm në shkallën e ndezshmërisë të materialit djegës. Në përgjithësi në terrenet të cilët kanë reliev të fortë me orientim nga jugu është lehtësisht më i ndezshëm se ai i orientuar nga veriu. Kjo edhe për vetë faktin e bimësisë që rritet në të.

Stinët me karakteristikat e tyre ndikojnë në ndezshmërinë e pyjeve. Vera me temperatura të larta të ajrit (tek ne rreth 40°) dhe periudha të gjata pa shi e rritin shkallën e ndezshmërise në pyje/kullota. Në këtë periudhë bari thahet , lagështia e tokës zvogëlohet në mënyrë drastike dhe përbën rrezik për zjarr. Kështu kjo periudhë quhet " periudhë kritike e vitit për shfaqjen e zjarreve në hapësirë të hapur". Edhe gjatë periudhës së dimrit për shkak të temperaturave shumë të ulëta kryesisht kur dimri është i thatë , për shkak të lagështisë së ulët të tokës , materiali djegës mund të ndizet lehtësisht. Klima në rajonin tonë si një klimë mesdhetare është favorizuese për zjarret si në hapësira të hapura ashtu edhe në zonat e pyjeve.

Ashtu siç kemi vënë re , shkaku kryesor i zjarreve (me apo pa qëllim) është njeriu. Hapja e rrugëve në zonat e pyjeve apo në afërsi të tyre përdorimi për piknik, rekreacion mbledhjen e produkteve të ndërmjetme pyjore përbën rrezik për zjarr. Por nga ana tjetër pavarësisht efektit negativ , është edhe ai pozitiv i cili mundëson një kontroll më të mirë të zonës apo qasje më të shpejtë të zjarrfikësve dhe automjeteve në rast zjarri.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

5. Masat mbrojtëse kundër zjarreve të pyjeve/kullotave.

Hapi i parë vendimtar në menaxhimin e zjarreve të pyjeve është identifikimi i atyre parametrave që mundësojnë vlerësimin e rritjes së probabilitetit të zjarrit.
Te gjitha masat e ndërmarra pë mbrojtjen kundër zjarreve të pyjeve/kullota, sipas kohës që janë ndërmarrë dhe synimit ndahen në:

- **masat parandaluese;**
- **masat përgatitore;**
- **masat e lokalizimit dhe shuarjes.**

5.1. Masat parandaluese

Këto masa për mbrojtjen e pyjeve/kullotave nga zjarret merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Këto masa ju drejtohen totalisht njerëzve. Qëllimi kryesor i këtyre masave është të parandalojnë shfaqjen e zjarreve nëpërmjet evidentimit dhe parandalimit të shkaktarëve (shkaqeve) duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në **zvogëlimin e numurit të zjarreve.**
Bazuar në këtë, ato janë masat me efektive për mbrojtjen e pyjeve/kyllotave nga zjarret dhe sipas karakterit dhe aplikimit të tyre ato mund të ndahen në:
a) Masa ligjore;
b) Masa edukative;
c) Masa informative-propaganduese.

a) ***Masat ligjore***

Shteti shqiptar i adreson këto çështje në Kushtetutë dhe ligjet e tjera dhe me aktet nënligjore. Sipas ligjit, parandalimi i zjarreve në pyje, kullota, tokës me barëra, gjatë proceseve të të korrave në toka bujqësore apo aktivitete pastrimi rrallimi në frutikulturë etj., është përgjegjësi e pronarëve apo përdoruesve (NjVV, AdZM, fermerë privatë, sipërmarrës) apo atyre që menaxhojnë këto zona. Meqë pyjet janë thesar kombëtar, të gjithë qytetarët janë përgjegjës për parandalimin e zjarreve. Kështu, qeveria kalon akte normative, të cilat janë përcaktuar më tej në aktet nënligjore.
NjVV-ja, AdZM-ja, pronarët privatë dhe menaxherët e zbatojnë këtë në praktikë në bazë të vendimeve, urdhëresave etj. Kjo nënkupton që parandalimi bazë i zjarreve në pyje është kryesisht një përgjegjësi e atyre që menaxhojnë pyllin/kullotën.
Legjislacioni përcakton masat dhe aktivitetet, të cilat duhet të merren nga subjektet përgjegjëse, për parandalimin e zjarreve në pyje sikurse dhe dënimet për të vepruar në përputhje me ligjin.
Legjislacioni ekzistues për Shqipërinë:

1. Ligj Nr. 57/2020, datë 30.04.2020: "Për Pyjet";
2. Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 *"Për Fondin Kullosor"*, i ndryshuar;
3. Ligji nr. 10120, datë 23.4.2009 *"Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore"* i ndryshuar;
4. Ligji nr. 45, datë 18.7.2019 *"për Mbrojtjen Civile";*
4. Ligj Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

5. Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF 2023- 2030) Datë: 31 gusht 2022;
6. VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 "Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive";
7. VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile";
8. VKM nr. 747, datë 20.11.2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile";
9. VKM nr. 531, datë 01.08.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile";
10. Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

b) ***Masat edukative***

Këto janë masat që përfshijnë edukimin e njerëzve. Ato mund të aplikohen me të gjitha grupmoshat, megjithatë janë me të suksesshme dhe të dobishme për të rinjtë. Këto masa kanë për qëllim të tregojnë rreziqet që sjell zjarri, por, gjithashtu, dobitë nga përdorimi korrekt i tij. Më efektive masat edukative janë te fëmijët parashkollorë dhe ata të shkollës fillore.
Këto masa mund të implementohen në disa mënyra: leksione të ndryshme për parandalimin e zjarrit në pyje e kullota; futja në shkolla e informimit të nevojshëm për zjarret dhe bërja e këtij informimi pjesë të kurikulave është një nga mënyrat më të suksesshme.
Media elektronike dhe e shkruar gjithashtu mund të përdoren (revistat, fletëpalosje, TV, radio, rrjete sociale etj.) përmes artikujve të përshtatshëm dhe shfaqjeve edukuese, ndërgjegjësuese. Për këtë qëllim mund të publikohen revista të specializuara shkollore me përmbajtje të pasur. Libra me fotografi apo lojëra të ilustruara që përfshijnë përmbajtjen, e cila ka të bëjë me mbrojtjen kundër zjarreve në pyje dhe që janë efektive për fëmijët parashkollorë dhe shkollorë. Qëllimi i tyre i fundit është që të familiarizojë fëmijët me këtë fushë dhe të nxisë dashurinë ndaj pyjeve/kullotave dhe natyrës dhe në veçanti të familiarizojë ata me pasojat dhe dëmet e zjarreve të pyjeve. E tërë kjo i ndihmon ata që të zhvillojnë një qëndrim të drejtë ndaj pyjeve si thesar kombëtar, dashurinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj pyjeve, se ata ruajnë të gjithë jetën e tyre. **Masat e përmendura më lart janë masa të përhershme, domethënë ato ndërmerren gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në periudhën e zjarreve të pyjeve.**

c) ***Masat informative-propaganduese***

Këto masa kanë për qëllim të paralajmërojnë apo informojnë publikun (vizitorët e pyjeve, punëtorët etj.) rreth rreziqeve nga zjarret në pyje, duke orientuar si të sillen në pyje dhe t'i udhëzojnë ata rreth masave të menjëhershme që duhen ndërmarrë në rast të zjarrit.
Këto masa mund të komunikohen në disa mënyra:
1. Duke vendosur shenja në vendet e dukshme (në rrugë kryesore dhe anësore) që kanë të bëjnë me ndalimin e ndezjes së zjarrit në zonat e hapura, duke i shënuar vendet në pyje ku lejohen zjarret, shenjat që ndalojnë lëvizjen në pyje etj.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

2. Nëpërmjet organizimit të takimeve dhe bisedave informative me grupe të ndryshme njerëzish, të cilët operojnë përkohësisht ose për një kohë të gjatë në pyje e kullota (barinj, fermerë, mbledhësit e frutave të pyjeve, biznese, turistë etj.)
3. Informacioni mund të komunikohet në forma të ndryshme, si: simbole, fletëpalosje, postera, debateve publike etj., me qëllim informimin rreth mbrojtjes së pyjeve nga zjarret.
   Për t'u siguruar që kanë ndikim të drejtë për njerezit që ne trajnojmë, duhet të mbajmë parasysh këto katër faktorë kryesorë:
   - Synoni njerëzit e duhur;
   - Përdorni/përcillni mesazhin e duhur;
   - Gjeni kohën e duhur për mesazhin;
   - Përdorimi mjetin/transmetuesin e duhur.

   Për të arritur një sukses më të madh, masat informative-propaganduese mund të kombinohen me masat edukative.



Bisedat informative me blegtorët

5.2 Masat përgatitore

Duke pasur parasysh faktin që masat parandaluese asnjëherë nuk mund të parandalojnë plotësisht shfaqjen e zjarreve të pyjeve/kullotave, janë të nevojshme gjithashtu masat e tjera të ashtuquajtura masa parapërgatitore për shuarjen e zjarreve.

Masat parandaluese synojnë në parandalimin apo zvogëlimin e numrit të zjarreve të pyjeve/kullotave, ndërsa masat parapërgatitore për shuarjen e zjarreve na mundësojnë që të shuajmë zjarret në pyje/kullota në një mënyrë të organizuar.

Këto masa ndërmerren gjatë gjithë vitit dhe përfshijnë:

- zbulimin e zjarrit shpejt (në kohë) - vrojtimi dhe njoftimi/sinjalizimi;
- përcjelljen e informacioneve;
- organizimin e transportit për zjarrfikësit;
- furnizimin me mjetet dhe pajisjet e duhura;
- rekrutimin dhe trajnimin e zjarrfikësve;
- ndërtimin e brezave ndarës të lëndës djegëse dhe korridoreve për luftimin e zjarreve;
- hartën e lëndës djegëse dhe reduktimin e lëndës djegëse;
- përcaktimin e rrezikut të zjarrit;
- planin vjetor të masave për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve e kullotave.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

5.2.1 Zbulimi i zjarrit shpejt (në kohë) - vrojtimi dhe njoftimi/sinjalizimi

Zbulimi i zjarrit në kohë është shumë me rëndësi për lokalizimin dhe shuarjen e shpejtë të tij. Zbulimi i hershëm i zjarrit kërkon organizimin e një njësie vrojtimi për shkak të faktit se zonat malore janë shpesh të vështira për t`u monitoruar dhe kanë një shtrirje të madhe në sipërfaqe. Është i rëndësishëm funksionimi i kësaj njësie, sidomos gjatë të ashtuquajturës "periudhë kritike" të vitit, kur numri i zjarreve në pyje/kullota është më i lartë.

Objektivat e zbulimit të hershëm/shpejt të zjarrit janë:

- ✓ zhvillimi i teknikave për zvogëlimin e ndezjes së padëshiruar të zjarreve;
- ✓ reduktimi i kostove për shuarjen e tyre;
- ✓ zvogëlimi i dëmeve në burimet natyrore dhe pasurive;
- ✓ reduktimi i rreziqeve të ekspozimit ndaj zjarrit.

Vrojtimi mund të kryhet në disa mënyra:

a) vrojtimi i terrenit nga kullat e vrojtimit;
b) patrullimi tokësor;
c) vrojtimi nga ajri;
d) vrojtimi automatik dhe elektronik.

a) Vrojimi i terrenit nga kullat e vrojtimit apo një pikë e lartë

Vrojtimi i terrenit nga një apo disa pika, bëhet prej personave (vrojtuesve) nga kullat e vrojtimit tashmë të ndërtuara apo nga ndërtimet ekzistuese. Vrojtuesit duhet të njohin terrenin dhe të pajisen me harta të zonës, të kenë në përdorim instrumente për përcaktimin e këndeve (busull), dylbi, radio apo instrumente sinjalizuese dhe vegla dore (lopatë, kazmë, fshesë metalike, enë me ujë etj.).



Kullë vrojtimi

b) Patrullimi tokësor

Ndjekja e rrugëve të caktuara përmes pyllit, në këmbë apo me mjete motorike, quhet patrullim. Patrullimi mund të organizohet me objektiv të veçantë ose të jetë pjesë e disa aktiviteteve të tjera të bëra nga i njëjti person (p.sh.: pylltarë, punëtorë të pyjeve, inxhinierë të pyjeve etj., krahas detyrave të tjera të menaxhimit, të kryejnë patrullimin.)

Personi apo personat që patrullojnë duhet të kenë mjete komunikuese në mënyrë që të raportojnë në kohë rënien e zjarrit.

Për të qenë të sigurt për mbulimin e gjithë zonës pyjore, hartohet dhe ndiqet një plan patrullimi.

Objektivat e këtij plani duhet të jenë:

- Reduktimi i numrit të zjarreve të padëshiruar në pyje;
- Parandalimi i dëmeve;
- Minimizimi i rrezikut të jetës, pasurisë natyrore dhe kulturore.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Plani duhet të jetë **i përgatitur mirë**, duke pasur parasysh:
- Historikun e zjarreve në zonë dhe potencialin e rënies së tij;
- Prioritizon vendndodhjen e zjarrit në pyje;
- Identifikon periudhat më efektive të kohës duke ruajtur **fleksibilitetin.**



Patrullimi në këmbë për zbulimin e hershëm të zjarreve

c) Vrojtimi nga ajri

Vendet më të zhvilluara apo vendet që posedojnë sipërfaqe të mëdha me pyje, përdorin mjetet ajrore (drone, aeroplanët, helikopterët etj.) për zbulim të zjarrit në kohë. Mund të formohet një skuadër speciale ajrore ose të përdoren aeroplanë sportivë. Aeroplanët që janë pjesë e njësive speciale mund të bartin ujë dhe menjëherë fillojnë shuarjen e zjarrit.

d) Vrojtimi automatik dhe elektronik

Ky lloj vrojtimi është mënyra më bashkëkohore për të zbuluar zjarret dhe kryesisht përdoret për sipërfaqet e pambërritshme dhe për sipërfaqet e mëdha me pyje. Këto stacione janë të pajisura me pajisje speciale (me kamera dhe pajisje të tjera elektronike), të cilat në mënyrë automatike dhe të pavarur (pa prezencën e njerëzve) vrojtojnë terrenin dhe në rast të zjarrit, dërgojnë informata në qendrën relevante.

Në mes të shumë përparësive, ekzistojnë dhe të meta, siç është dhënia e alarmit të rremë, shkaktuar nga tufa zogjsh apo insektesh, të cilat regjistrohen nga stacioni, si tym zjarri etj.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

5.2.2 Përcjellja e informatave

Zbulimi i zjarrit ne kohë pa përcjelljen e shpejtë të informatave, nuk do të kishte efektin e dëshiruar. Mënyra më e mirë për përcjelljen e informatave është përdorimi i mjeteve komunikuese. Kërkohet një rrjet i transmetueseve me kualitet të lartë dhe ritransmetues, të cilët të mundësojnë një kualitet të lartë dhe me mbulim në të gjithë territorin, si dhe pajisje të përshtatshme për vrojtuesit (radio, telefon celular).

5.2.3 Organizmi i transportit për zjarrfikësit

Organizimi i transportit për zjarrfikësit ka një rëndësi të madhe edhe për vetë zjarrin. Nëse kemi zbuluar me kohë zjarrin dhe kemi përcjellë shpejt informacionin, transporti i organizuar i zjarrfikësve, u mundëson atyre që të arrijnë në vendin ku ka ndodhur zjarri, duke lokalizuar dhe shuar atë.

Zjarrfikësit dhe pajisjet e tyre mund të transportohen duke përdorur kafshë, fuoristrada, automjete speciale, helikopterë etj. Kjo varet nga karakteristikat e terrenit ku ka ndodhur zjarri, si dhe nga mjetet financiare në dispozicion apo infrastruktuara logjistike. Rrugët dhe koha e nevojshme për transport duhet të planifikohen paraprakisht, pasi zvogëlojnë shumë kohën e ndërhyrjes kur ndodh një zjarr.

5.2.4 Furnizimi me vegla dhe pajisje të duhura

Pavarësisht nga numri i mjaftueshëm i zjarrfikësve të trajnuar, furnizimi me vegla dhe pajisje të përshtatshme për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit ka një rëndësi të madhe.

Kjo na bën të kuptojmë se furnizimi me vegla dhe pajisje për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve nuk duhet të jetë gjithnjë i njëjtë pasi domosdoshmëria e pasjes së tyre varet nga disa faktorë si: lloji i lëndës djegëse, konfiguracioni i terrenit, trajnimi i zjarrfikësve etj. Për shembull, për një zonë ku dominon bari, kërkohen fshesat e hekurit, lopatat metalike, kazmat, enët me ujë etj., ndërsa për zonën me pyje të larta, pavarësisht nga veglat e listuara më lart, kërkohen motorsharrat, sëpatat, makineritë më të rënda (buldozeri, traktori etj).

Veglat e dorës gjithmonë duhet të jenë në gjendje pune (të mprehura, me doreza të forta etj.) dhe të mbahen në vende të veçanta për atë qëllim.

Makineritë e rënda që përdoren në punët e përditshme, mund të mobilizohen gjatë zjarreve në pyje duke garantuar funksionimin dhe gatishmërinë teknike të tyre.

Kushtet që duhet të plotësohen nga veglat dhe pajisjet janë që:

- të kenë efikasitet dhe produktivitet më të lartë;
- të jenë universale;
- të mund të transportohen lehtë;
- të jenë të qëndrueshme, p.sh.: të jenë të bërë nga një material me cilësi të lartë;
- të jenë të thjeshta për t'u përdorur.

Sipas llojit të punës së kryer me vegla dhe pajisje, ato mund të ndahen në:

- pajisje dhe vegla për prerjen dhe rrëzimin e trungjeve;
- pajisje dhe vegla për mbledhje, shtyrje dhe goditje;
- pajisje dhe vegla për gërmim dhe ndërtimin e zjarr-ndarësve;
- pajisje për ujë;
- pajisje për fillimin e zjarrit të kundërt;
- pajisje për ndriçim gjatë shuarjes së zjarrit natën;
- pajisje dhe vegla për minim.



Vegla për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

5.2.5 Rekrutimi dhe trajnimi i zjarrfikësve

Lokalizimi dhe shuarja e zjarreve të pyjeve është aktivitet shumë i vështirë fizik dhe psikologjik. Në shumicën e rasteve, kushtet e terrenit janë të rënda (temperaturë e lartë, zonat e pakalueshme dhe të pjerrëta, përqendrim i lartë tymi etj.).

Zjarrfikësit e zgjedhur duhet të jenë fizikisht dhe mentalisht të shëndetshëm, si dhe të trajnuar mirë. Ata duhet të njohin taktikat e lokalizimit dhe shuarjes, si dhe veglat e pajisjet për ato qëllime.

5.2.6 Ndërtimi i brezave ndarës të lëndës djegëse dhe korridoreve për luftimin e zjarreve

Me qëllim lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve të mëdha pyjore, zjarrfikësit duhet të kenë pozicion të sigurtë mbrojtës nga ku ata do të shuajnë zjarrin. Për shkak të nxehtësisë së lartë dhe shpejtësisë së përhapjes, këto pozicione krijohen në një distancë të caktuar, në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Lënda djegëse duhet të hiqet në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Për të fituar më tepër kohë, heqja e lëndës djegëse nga ndërprerësja e zjarrit bëhet para rënies së zjarrit. Brezat ndarës të lëndës djegëse (korridoret e mbrojtjes nga zjarri) janë vende përgjithësisht të pastruara nga lënda djegëse. **Ato krijohen gjatë aktiviteteve të rregullta pyjore dhe janë zona të pastra, pa asnjë lëndë djegëse.** Nganjëherë, bimët që nuk digjen lehtë, mund të rriten në brezat ndarës të lëndës djegëse.

Edhe kombinimi i halorëve me fletorë mund të krijojë një brez ndarës mjaft të efektshëm. Gjerësia e brezave ndarës ndryshon, varësisht nga lartësia e trungjeve, pjerrësia e terrenit, lartësia e flakës (lartësia e pritshme e flakës) etj., por mesatarisht ato variojnë nga 6-50 metra të gjera. Brezat ndarës të lëndës djegëse gjithashtu mund të shërbejnë si korridore për ndërhyrje të shpejtë për luftim të zjarrit.

Brezat ndarës të lëndës djegëse mund të krijohen duke përdorur një nga teknikat / mjetet e mëposhtme:

- Herbicidet - kërkon planifikim më parë;
- Eskavatorë dhe buldozerë;
- Bimësi të prerë - heqje totale;
- Shkumë - kohëzgjatja e shkurtër;
- Djegie vegjetacioni (e kontrolluar);
- Mbjellje të llojeve vështirë të djegshëm dhe të kombinuar (halorë - fletorë):



Brez ndarës i lëndës djegëse i pastruar



Një rrugë auto si brez ndarës i lëndës djegëse

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

5.2.7 Harta e lëndës djegëse dhe reduktimi i lëndës djegëse

Siç u përmend edhe më sipër, pavarësisht nga faktorët e tjerë, mundësia e një brezi ndarës zjarri dhe sjellja e zjarrit varen nga lloji i lëndës djegëse dhe karakteristikat e saj.

Njohja e karakteristikave dhe shpërndarjes së lëndës djegëse përcakton masat e nevojshme, të tilla si zgjedhja e mjeteve të përshtatshme dhe pajisjeve të shuarjes së zjarrit në pyll/kullotë, zgjedhja e taktikave të shtypjes në rrethana të caktuara (moti, konfigurimi i terrenit) etj.

Për shkak të kësaj rëndësie të lëndës djegëse, dhe me qëllim që të fitohet një pasqyrë e qartë e gjendjes në terren, lënda djegëse është ***hartografuar*** dhe klasifikuar në klasat e lëndës djegëse. Këto të dhëna shërbejnë për të organizuar më mirë mbrojtjen kundër zjarreve si pjesë e masave të tjera parapërgatitore.

Masat e reduktimit të lëndës djegëse merren në vendet ku është vlerësuar se sasia e lëndës djegëse është e lartë dhe e karakteristikave të tilla që ajo posedon një kërcënim të shfaqjes së zjarrit. Kjo mund të kryhet në disa mënyra që varen nga lloji i bimësisë, pajisjeve dhe e legjislacionit në dispozicion etj.:

- lëvizje e barit;
- trajtimit me herbicide;
- djegie të parashikuar/të kontrolluar etj.

Djegia e parashikuar/kontrolluar është zbatimi i planifikuar i zjarrit në kushtet e përcaktuara mjedisore dhe brenda kufijve të përcaktuar, për të arritur objektivat e menaxhimit të burimeve.

Përdorimi i zjarrit (djegia e parshikuar/kontrolluar) është një mënyrë shumë efektive për reduktimin e lëndës djegëse, por përdorimi i saj kërkon njohuri dhe eksperiencë të madhe. Kjo mënyrë e uljes së lëndës djegëse më shpesh përdoret për të eliminuar mbetjet pas prerjeve, veçanërisht prerjeve sanitare, dhe është përdorur në përgjithësi për zvogëlimin e lëndës djegëse gjatë aktiviteteve të rregullta pyjore.

Trajnimi i duhur i personave, kombinuar me legjislacionin, do të kontribuojë ndjeshëm në uljen e numrit të zjarreve.

Gama e objektivave përfshin:

- Krijimin e korridoreve kundra zjarrit;
- Ulje e ngarkesave të lëndëve djegëse;
- Përmirësimi i habitateve për kafshë të egra;
- Hapja e tokave të reja bujqësore;
- Përmirësimi i kullotës;
- Heqja e vegjetacionit sipërfaqësor dhe shtresës së mbeturinave të sipërme për të ndihmuar rigjenerimin natyral të drurëve apo shkurreve;
- Heqja e degëve, mbetjeve të rezultuara nga rrëzimi i drurëve dhe hapja e rrugëve për rimbjellje;
- Ofrim i një plehërimi natyror të tokës;
- Ruajtja e peizazheve kulturore të hapura.

5.2.8 Përcaktimi i rrezikut të zjarrit

Qëllimi kryesor i kësaj mase është për të përcaktuar rrezikun e një rënieje zjarri në hapësirë dhe kohë sa më saktësisht të jetë e mundur.

Kjo do të thotë t'i përgjigjesh pyetjes:

A ka kushte lënda djegëse për të filluar djegien dhe ku?

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje ka disa metoda me saktësi të ndryshme, bazuar kryesisht në kushtet e motit dhe karakteristikat e lëndës djegëse. Ky vlerësim mund të jetë afatgjatë dhe afatshkurtër.

Metoda afatgjatë është e bazuar në të dhënat e fundit statistikore, karakteristikat klimatike të rajonit, llojin e vegjetacionit, faktorin njeri etj. Kjo metodë ka saktësi më të ulët dhe i referohet një periudhe më të gjatë kohe.

Metoda afatshkurtër e vlerësimit të rrezikut nga zjarri, pra parashikimi i përditshëm, është më e rëndësishme. Ajo bazohet në kushtet e motit gjatë ditës dhe në gjendjen e lëndës djegëse (kryesisht në përqindjen e lagështisë në të). Në fakt, kjo metodë përllogarit probabilitetin e rënies së zjarrit brenda një periudhe 24-orëshe. Ajo u mundëson institucioneve përkatëse dhe pjesës tjetër të qytetarëve për të marrë masa me qëllim ndalimin e shpërthimit të zjarrit (masa të përcaktuara për çdo shkallë rreziku) ose për të rritur shkallën e gatishmërisë së forcave të luftimit të zjarrit të bazuar në kohë.

Intensiteti i zjarrit mund të shprehet në kilovat (kw) për metër linear. Intensiteti i zjarreve test është llogaritur duke përdorur një formulë australiane dhe mund të lidhet me lartësinë e flakës. Intensiteti i zjarrit do të ndryshojë me ndryshimin e kushteve. Për shembull, një rritje në lartësi të shqopës (rrit sasinë e lëndës djegëse) po të shoqërohej me një rritje në shpejtësi të erës, do të rrisë ndjeshëm intensitetin e zjarrit. Një dyfishim i lëndës djegëse në dispozicion mund të katërfishojë intensitetin e zjarrit.

Intensitetet e linjës së zjarrit, lidhur me fazat e rritjes së shqopës, bazuar në lartësinë e flakës në kushtet australiane, janë paraqitur në tabelë (ANEKS 5). Lartësia e flakës matet pingul me tokën, ndërsa gjatësia e flakës është distanca përgjatë gjatësisë së flakës, që zakonisht është më e madhe se lartësia. Sistemet e shuarjes për intensitetet e dhëna janë të lidhura gjithashtu me klasifikimin Australian të Rrezikut të Zjarrit. Për të parashikuar rrezikun e zjarrit në një vend të caktuar, shkalla e mundshme e përhapjes (ROS), intensiteti i vijës së zjarrit, duhet të jetë e njohur më parë qasja dhe shtrirja e fronteve të zjarrit. Për llogaritjen e intensitetit të vijës së zjarrit, të cilat mund të lidhen drejtpërdrejt me lartësinë e bimësisë së shqopës, duhet të dihen (njihen) sasitë e lëndës djegëse.

Puna mund të vazhdojë duke krijuar një metodë në përputhje të parashikimit të sasive të lëndës djegëse për të gjitha llojet e bimësisë. Me këtë informacion do të jetë e mundur që të përcaktohet se cili sistem shuarjeje është më i përshtatshëm për t'u zbatuar, duke përdorur të dhënat e mbledhura më parë për të llogaritur kohën e nevojshme për shuarjen e zjarrit.

Nëse do të dispononim këto të dhëna, atëherë për zjarret e mëdha do të ishte e mundur të vlerësohej se sa larg do të përhapej zjarri dhe nëse do të ishte e mundur që me burimet aktuale do të arrihej në kohën e duhur te zjarri. Megjithatë, edhe pse kjo është një metode e mirë dhe e strukturuar, ajo mund të prishet nga mungesa e të dhënave/informacionit në dispozicion dhe ndryshimet e kushteve në pjesën ballore të zjarrit. Ky informacion mund të shërbejë si bazë për të justifikuar thirrjen e helikopterëve, e cila është parë shpesh si një alternativë e shtrenjtë dhe me afat të shkurtër. Metoda mund të përdoret për të planifikuar krijimin e ndërprerësve të zjarrit dhe llogaritur terrenin e humbur.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

5.2.9 Plani vjetor i masave për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve e kullotave

Strukturave që menaxhojnë pyjet/kullotat dhe tokat pyjore, u kërkohet nga ligji të përgatisin planet operacionale vjetore për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota.

Këto plane duhet të përbëhen nga tri pjesë.

Në pjesën e parë, jepet një përmbledhje dhe analizë e gjendjes së zjarreve në pyje në të kaluarën në rajon, duke marrë parasysh të gjitha aspektet (numrin e zjarreve, shkaqet, zonën e djegur, pajisjet për shuarjen e zjarrit dhe mjetet e përdorura, taktikat, numrin e personave të përfshirë, kushtet e motit, orën kur filloi zjarri, vendndodhjen etj.).

Pas nje analize të hollësishme në pjesën e parë, duke u bazuar në të dhënat, në pjesën e dytë planifikohen masat parandaluese dhe të shuarjes për vitin e ardhshëm.

Pjesa e tretë përbëhet nga një listë e detajuar e personave që do të zbatojnë këto masa, me datat e sakta dhe duke përfshirë afatet. Për qëllime të vrojtimeve të planifikuara gjatë periudhës kritike të vitit për rënien e zjarrit, duhet përgatitur një listë e hollësishme e personave, pajisjeve dhe automjeteve të ndara në ekipe me orare vrojtimi.

Procedurat që duhen ndjekur në situata të caktuara dhe harta të ndryshme (harta e lëndëve djegëse, rrugët, rezervuaret e ujit etj.), duhet të përfshihen si shtojca të këtij plani.

Ajo që përshkruam më sipër tregon qartë rëndësinë e masave përgatitore, të cilat janë të një rëndësie të madhe. Efikasiteti i masave luftuese varet nga to.

5.3 Masat direkte të lokalizimit dhe shuarjes

Pavarësisht nga masat parandaluese, gjithmonë do të ndodhin zjarre në zonat e hapura. Për këtë arsye, hartohen masat që ndërmerren gjatë një zjarri, dhe qëllimi i tyre është të lokalizojnë dhe shuajnë zjarrin . **Për të lokalizuar apo shuar një zjarr, është e domosdoshme të eliminohet një nga elementet e të ashtuquajturit trekëndësh i Osbornit (zjarrit),** domethënë materiali që është duke u djegur, burimi i nxehtësisë ose oksigjeni. Nisur nga materiali që përdorim për e shuarjen e zjarrit, metodat emërtohen:

a) Shuarja e zjarrit me dhe (metoda e dheut);
b) Shuarja e zjarrit me ujë (metoda e ujit);
c) Shuarja e zjarrit me zjarr (metoda e zjarrit);
d) Shuarja e zjarrit me substanca kimike (metoda kimike);
e) Shuarja e zjarrit me eksploziv (metoda eksplozive);
f) Shuarja e zjarrit me aeroplan (hedhja e ujit nga ajri).

Si do të aplikohen këto metoda në kushtet e terrenit për fikjen e zjarreve?



Heqja e disa elementeve të trekëndëshit të zjarrit

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

a) ***Shuarja e zjarrit me dhe (metoda e dheut)***

Metoda e shuarjes së zjarrit nëpërmjet hedhjes së dheut është metoda më e vjetër e shuarjes së zjarrit. Ne këtë metodë përdoret dheu ose rëra.

Në varësi të taktikave të përdorura për shuarjen, dheu hidhet direkt në pjesën e përparme të flakës.

Dheu vepron si izolator, duke shmangur kontaktin e oksigjenit me lëndën djegëse. Duke mbuluar materialin që digjet me dhe, ajri nuk mund të bjerë në kontakt me të dhe djegia ndalet). Gjithashtu, dheu vepron si izolator i nxehtësisë. Kjo do të thotë se energjia e nxehtësisë që është e nevojshme për djegien e një druri, nuk mund të hyjë në të për shkak të shtresës së dheut mbi lëndën djegëse. Prandaj, në këto kushte, lënda djegëse nuk mund të ndizet, ose së paku nuk mund të ndizet lehtë.



b) ***Shuarja e zjarrit me ujë (metoda e ujit)***

Siç është konstatuar tashmë, metoda me ujë është forma më e njohur për shuarjen e zjarrit. **Uji ka ndikim të shumëfishtë në procesin e djegies.**

Së pari, lagështia në materialin që digjet, ose në materialin në zonën para pjesës së përparme të zjarrit, humb energjinë e nxehjes përmes procesit të avullimit, duke ulur kështu temperaturën poshtë pikës së ndezjes. Si rezultat, zjarri shuhet.

Së dyti, për shkak të avullimit të ujit, prezenca e avullit në ajër rritet. Avulli dhe tymi i çliruar nga zjarri zvogëlojnë përqindjen e oksigjenit ne ajër, gjë që çon në zvogëlimin e intensitetit të zjarrit, ose nganjëherë e shuajnë atë (në varësi të dendësisë së avullit dhe tymit).

Ekziston një numër taktikash dhe pajisjesh të ndryshme për këtë metodë (nga ato manuale deri te pajisjet mekanike). Është një metodë shumë e suksesshme, por problemi është që uji nuk gjendet gjithmonë afër zjarrit. Prandaj, duhet gjithmonë të transportohet ne vendndodhjen e zjarrit. Transporti është një problem serioz për shkak të sipërfaqeve malore të paarritshme, të cilat e bëjnë zbatimin e kësaj metode më të vështirë dhe zvogëlojnë efektivitetin e saj.



c) Shuarja e zjarrit me zjarr (metoda e zjarrit)

Në këtë metodë, përdoret zjarri për të shuar zjarrin. Kjo metodë e pastron terrenin nga lënda djegëse që e shuan zjarrin. Në fakt, ajo varet nga taktikat e përdorura për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri kryesor. Zjarri i "kontrolluar" (i cili mund të lëvizë në drejtim të njëjtë apo të kundërt me zjarrin kryesor) djeg lëndën djegëse në zonë përpara se të ndizet nga pjesa e përparme e zjarrit.

Kur zjarri arrin zonën ku ka qenë zjarri "i kontrolluar", aty nuk ka mbetur asgjë për t'u djegur, dhe kështu zjarri shuhet.

Vlen të theksohet se kjo metodë është shumë efektive, por e rrezikshme.

Këtë metodë e përdorin vetëm ekspertët dhe personat me përvojë (zjarrfikësit), duke e ruajtur plotësisht zjarrin e "kontrolluar", domethënë duke e ruajtur që të mos dalë jashtë kontrollit dhe të ketë pasoja të padëshiruara.

Ndezja dhe kontrolli i këtij zjarri duhen bërë kundër erës dhe/ose pjerrësisë së shpatit. Mos përparoni me ndezjen e zjarrit më shpejt nga sa mund të ndjekin forcat e kontrollit. Lënda djegëse jashtë brezit të kontrollit mund të shuhet me qëllim ndalimin e daljes së zjarrit nga brezi i kontrollit.

Ndezja e lëndës djegëse mund të bëhet në një apo më shumë breza, duke i lënë ato të digjen në të njëjtën kohë. Kjo lejon një djegie më të shpejtë. Gjerësia dhe vendosja e brezave, përkundrejt pozicionimit të shpatit apo drejtimit të erës, rregullojnë intensitetin e djegies.

Metoda e ndezjes rrethore mund të përdoret përreth ndërtesave apo në zona të caktuara.

Në mënyrë që të kemi kontroll të plotë të këtij zjarri, duhet të merren disa masa paraprake, si: ekipet e zjarrfikësve të pajisen me pajisjet e duhura, përdorimi i ujit në dispozicion nga depozita me ujë të jetë siguruar etj.

Sigurohuni që të gjitha zonat e nxehta dhe rrugët e mundshme për devijimin e zjarrit të jenë nën kontroll nga forcat e kontrollit të zjarrit.



d) Shuarja e zjarrit me substanca kimike (metoda kimike)

Në këtë metodë të shuarjes përdoren substanca të ndryshme kimike. Në parim, kjo është një metodë me ujë, për faktin se të gjitha substancat kimike, gati pa përjashtim, treten në ujë dhe përmirësojnë karakteristikat e tij. Deri në 70% e ujit të përdorur për shuarjen e zjarreve të pyjeve humbet.

Kjo është arsyeja pse shtohen substanca të ndryshme kimike për të përmirësuar efektin e shuarjes.

Midis shumë avantazheve, e meta më e madhe e metodës kimike është çmimi i substancave kimike (disa prej të cilave janë shumë të shtrenjta), disa e dëmtojnë mjedisin, domethënë ndotin ambientin ose janë toksike. Së fundi, i është kushtuar shumë vëmendje aspektit mjedisor të substancave kimike, dhe pothuajse të gjitha substancat që përdoren janë miqësore me mjedisin.

e) Shuarja e zjarrit me eksploziv (metoda eksplozive)

Sipas rrethanave të caktuara, mund të përdoret eksplozivi për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve të pyjeve/kullotave. Kjo varet nga nevoja, eksplozivi mund të përdoret si shtesë në metodat e tjera (heqja e cungjeve, gërmimi i kanaleve, ndërtimi i brezave ndalues/mbrojtës etj.), apo direkt për shuarjen e zjarrit.

Kur përdoret drejtpërdrejt për shuarje, eksplozivi funksionon në dy mënyra. Mënyra e parë, kur eksplozivi i vendosur në tokë shpërthen, krijohet një "re pluhuri" e madhe, e cila zvogëlon përqindjen e oksigjenit në ajër, duke zvogëluar intensitetin e zjarrit ose e shuan tërësisht atë. Ky shpërthim, gjithashtu, heq lëndën djegëse, duke bërë që të mos mbetet asgjë për t'u djegur. Mënyra e dytë përfshin një shpërthim të shkaktuar në momentin kur kreu i zjarrit është mbi eksploziv. Përveç sa u tha më lart, në këtë rast, ajri shpërndahet me shpejtësi (një shpërthim) si rezultat zjarri mbetet pa ajër, pra pa oksigjen, kështu që shuhet.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Kjo është një metodë shumë efektive që mund të zëvendësojë shumë zjarrfikës, por në të njëjtën kohë është jashtëzakonisht e rrezikshme, po qe se nuk aplikohet korrekt dhe në kohë. Për shkak të gjitha këtyre, përdorimi i eksplozivit duhet bëhet me shumë kujdes nga ekspertët dhe personat e trajnuar për këtë qëllim.



f) Shuarja e zjarrit me aeroplan (hedhja e ujit nga ajri)

Në parim, kjo është një metodë shuarjeje me ujë (nganjëherë edhe kimike), por për shkak që është shumë specifike, klasifikohet si metodë e ndarë. Përveç aeroplanëve, helikopterët gjithashtu përdoren për këtë metodë në ditët e sotme. Ekzistojnë lloje të specializuara aeroplaanësh për këtë qëllim, por përdoren edhe aeroplanë të tjerë.

Kjo është një metodë shumë e përshtatshme për shkak të shpejtësisë së aeroplanëve dhe helikopterëve, kapacitetit të tyre (mund të mbulojnë territore të mëdha), hyrja e tyre në terrene të paarritshme (posaçërisht në male), sasia e ujit që ata mund të transportojnë etj.

Lokalizimi apo shuarja e zjarrit mund të bëhet individualisht, apo në kombinim me zjarrfikësit në terren.



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

6. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor.

6.1. Zonat me risk në Bashkinë Maliq dhe historiku i zjarreve

- Zonat sipas Ekonomive Pyjore.

Bashkia Maliq ka në territorin e saj shtatë ekonomi pyjore. Në tabelën më poshtë kemi pasqyruar zonat sipas ekonomive pyjore me emërtimet përkatëse të ekonomive, numrin e nëngastrave që këto ekonomi kanë sipas planeve të menaxhimit, sipërfaqen totale për secilën ekonomi pyjore dhe fshatrat që ndodhen në brendësi të këtyre ekonomive pyjore, për të pasur një orientim mbi shtrirjen e këtyre zonave dhe për të bërë më pas në pikën II një kategorizim më të qartë.

Ekonomia Pyjore	Numri i nëngastrave në Ekonominë Pyjore	Sipërfaqja totale e Ekonomisë Pyjore (ha)	Fshatrat që ndodhen në Ekonominë Pyjore
Ekonomia Pyjore Zëmblak – Mali i Thatë	138	2713.8	• Bregas • Burimas • Plasë • Podgorie • Shëngjergj • Zëmblak • Zvezdë
Ekonomia Pyjore Pirg-Mocan	530	6239	• Babjen • Beras • Bubuq • Desmirë • Dolanec • Gurishte • Kakaç • Këmbëthekër • Leminot • Lozhan • Manastirec • Marjan • Memël • Mjaltas • Moçan • Novoselë • Pirg • Qenckë • Qershizë • Shkozë • Sovjan • Symiz • Velitërn • Zboq

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Ekonomia Pyjore Maliq-Lozhan	378	5875.5	• Bickë • Dolan • Fshat Maliq • Gjinikas • Gjyras • Goçë • Klocë • Kolanec • Libonik • Lozhan • Lumaj • Maliq (Qyteti) • Osojë • Plovisht • Pocestë • Senisht • Tresovë • Vashtëmi • Zvarisht
Ekonomia Pyjore Mesmal	199	3053.6	• Mesmal • Selcë • Velçan
Ekonomia Pyjore Strelcë	339	4440.2	• Strelcë • Shalës
Ekonomia Pyjore Moglicë	357	6311.6	• Dobërçan • Gopesh • Gurshqipe • Kucakë • Maliq-Opar • Moglicë • Nikollarë • Peshtan • Protopapë • Shpatmal • Torovec
Ekonomia Pyjore Bofje Dushar	198	3902.6	• Bardhas • Dushar • Gurkuq • Zerec

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

- **Kategorizimi i nivelit të riskut sipas Ekonomive Pyjore dhe ngastrave/nëngastrave.**

Në tabelën më poshtë ju kemi pasqyruar kategorizimin e nivelit të riskut sipas shtatë ekonomive pyjore që shtrihen në territorin administrativ të Bashkisë Maliq.
Për kategorizimin e riskut jemi bazuar mbi bimësinë pyjore që mbulojnë përqindjen më të madhe të secilës ekonomie pyjore dhe jemi bazuar kryesisht mbi historikun e këtyre ekonomive pyjore për pesë vitet e fundit të rasteve të zjarreve më seriozë të cilët kanë arritur të shkaktojnë dëme në një shkallë nga dëme të ulëta në dëme të larta, raste të cilat janë vënë në kontroll vetëm për shkak të ndërhyrjes së skuadrave të cilat kanë marrë pjesë për fikjen e zjarreve.

Ekonomia Pyjore	Përshkrimi i zonës nga zjarret dhe historiku i tyre	Kategoria e riskut
Ekonomia Pyjore Zëmblak – Mali i Thatë	Pavarësisht se nga Bashkia Maliq në këtë ekonomi pyjore nuk ka të dhëna të regjistruara për zjarret sepse në këtë ekonomi shtrihet zona e mbrojtur e Prespës dhe menaxhohet nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Korçë por nga kontributi tonë për fikjen e zjarreve në ndihmë të AdZM Korçë është evidentuar se kjo zonë e cila është kryesisht kullotë e Malit të Thatë ka pasur vazhdimisht raste zjarresh.	**I lartë**
Ekonomia Pyjore Pirg-Mocan	Ka pasur një historik zjarresh por kryesisht raste të vogla me zjarre sipërfaqësor dhe me dëme shumë të vogla në bimësi. Janë regjistruar: ▪ Një rast zjarri në vitin 2022 në ngastrën nr. 51a. ▪ Dy raste zjarri në vitin 2024 në ngastrat 70b dhe 156a	**I Mesëm**
Ekonomia Pyjore Maliq-Lozhan	Kjo ekonomi pyjore ka një historik zjarresh me raste të shumtë dhe tepër seriozë me dëme të shumta. Janë regjistruar: ▪ Një rast zjarri në vitin 2023 në dy ngastra pyjore nr.40a dhe 41 ▪ Një rast zjarri në vitin 2024 në ngastrat 92a,93a,93c,93d,94a, 95a,95c,96a,96b,97a,98b,132,134a,134b,135. Ky ka qenë zjarri me sipërfaqen dhe dëmet më të larta që ka pasur në territorin e Bashkisë Maliq në 5 vitet e fundit.	**I Lartë**
Ekonomia Pyjore Mesmal	Në këtë ekonomi pyjore nuk ka pasur shumë raste zjarresh dhe kryesisht kanë qenë sipërfaqësor dhe pa dëme. Janë regjistruar: ▪ Një rast zjarri në vitin 2021në ngastrën nr.141	**I Ulët**

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Ekonomia Pyjore Strelcë	Kjo ekonomi pyjore ka një historik zjarresh dhe një nivel risku të lartë. Në këtë zonë kemi dhe rastin e fundit të zjarrit në pyje në vitin 2025 si rast serioz dhe me dëme. Janë regjistruar: ▪ Një rast zjarri në vitin 2023 në ngastrën nr. 79a ▪ Një rast zjarri në vitin 2025 në ngastra 66a dhe 67a në pyll pishe me sipërfaqe dhe dëme të konsiderueshme.	**I Lartë**
Ekonomia Pyjore Moglicë	Në këtë ekonomi pyjore nuk ka pasur shumë raste zjarresh dhe kryesisht kanë qenë sipërfaqësor dhe pa dëme. Janë regjistruar: ▪ Një rast në vitin 2021 në ngastrën 29a	**I Ulët**
Ekonomia Pyjore Bofje Dushar	Në këtë ekonomi pyjore nuk kemi pasur raste zjarresh të regjistruar.	**I Ulët**

6.2. Struktura e Bashkisë Maliq për organizimin e skuadrave për shuarjen e zjarreve

Në rast se në fondin pyjor bie zjarr, organet e shërbimit pyjor, organet e njësive të qeverisjes vendore, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij. Skema operacionale nga manuali për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri është si më poshtë:



Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

Bashkia Maliq me strukturat e saj , Njësitë Administrative , Sektori i Pyjeve dhe Kullotave , Emergjencat Civile, Sektorin e Bujqësisë, në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër, për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në administrim të saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë:

-Në rastet e zjarreve në pyje/kullota në territorin e Bashkisë Maliq ngrihet dhe funksionon shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i cili drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë për "Organizimin e ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit". Krijimi i skuadrave Vullnetare, trajnimi i tyre mbështetja e tyre nga shërbimi pyjor pranë bashkisë Maliq.

-Për **Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave** ky shtab **kryesohet nga Z. Gëzim Topçiu** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Maliq dhe përbëhet nga:
Z. Sadik Halili – MZSH Bashkia Maliq.
Z. Klarsen Brako – Përgjegjës Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Nebi Sulejmani – Kordinator Sektori Menaxhimit Pyje Kullota.
Z. Arben Hoxha – Përgjegjës Inspektimi, Sektori Inspektimit.
Z. Niko Demollari – Përgjegjës, Sektori Pylli i Fazanëve.
Z. Petrika Theodhosi – Specialist Sektori i Pyjeve dhe Kullotave.
Z. Rezart Bezhani – Teknik Kordinator Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Artan Fraholli – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Artan Petriti – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Trifon Seranllari – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Tomorr Belishta – Teknik Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z, Niko Xega – Inspektor Kordinues Pune
Z. Romeo Koro – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Ergys Skënderi – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Sokol Kellezi – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Z. Donald Beqiraj – Inspektor Pyje/Kullota Bashkia Maliq.
Për njësitë Administrative:
Z. Rudina Bregu – Administratore Njësia Libonik.
Z. Kreshnik Azo – Administrator Njësia Pojan.
Z. Fetah Hoxha – Administrator Njësia Moglicë.
Z. Qezar Bezati – Administrator Njësia Vreshtas.
Z. Ronaldo Skënderi – Administrator Njësia Gorë.
Z. Ermal Gjona – Administrator Njësia Pirg.

- Pranë Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Maliq ngrihet shtabi i Sektorit i cili ka të organizuar sistemin e vrojtim-sinjalizimit me anë të strukturës së Vrojtuesve prej 7 punonjës pylli / zjarri.

- Të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Maliq të organizojnë/riorganizojnë "Shërbimin vullnetar të mbrojtjes nga zjarri" . Këto skuadra përbëhen nga 8-10 anëtarë dhe do të mbahen në eficiencë të plotë nga Njësia Administrative nëpërmjet Teknikëve të Pyjeve . Skuadra e "Shërbimit vullnetar të mbrojtjes nga zjarri" do të jenë strukturat e para që së bashku me strukturat e tjera pyjore do të mbajnë nën kontroll zjarrin deri në mbërritjen e forcave dhe mjeteve që do të organizohen nga Shtabi i Bashkisë Maliq Afati i realizimit : Mars -Prill 2026.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

- Struktura "Njësitë Vullnetare për shuarje Zjarri" /teknikët e pyjeve , nëpërmjet Strukturës së Sektorit të Pyjeve dhe MZSH Bashkia Maliq ,do të kualifikohen për mënyrën e shuarjes së zjarrit në pyje/kullota. Afati i realizimit : Prill-Maj 2026.

- Bashkia Maliq nëpërmjet strukturave të saj të Sektorit të Pyjoreve/Kullotave , Emergjencave Civile dhe MZSH, shoqatave të përdoruesve të Pyjeve dhe të kullotave , etj. do të organizojë biseda me komunitetin e zonave Pyjore, nxënësve të shkollave në këto zona mbi sensibilizimin e opinionit për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve/kullotave : Afati i realizimit: gjatë gjithë vitit.

- Bashkia Maliq nëpërmjet Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave do të realizojë Hartën e Zonave të Rrezikuara nga Zjarri për Pyjet/Kullotat në territorin e Bashkisë Maliq. Kjo Hartë do të bëhet publike në të gjitha Njësitë Administrative të cilat kanë zonë pyjore të rrezikuar, shkollat si edhe ambiente të tjera publike. Kjo hartë do ti vihet në dispozicion edhe Emergjencave Civile dhe MZSH. Afati i realizimit: maj 2026.

- Bashkia Maliq nëpërmjet Sektorit të Shërbimit Pyjor do të realizojë Hartën Operative të Mbrojtjes nga Zjarri për Pyjet/Kullotat në territorin e Bashkisë Maliq. Kjo Hartë do të përmbajë të gjithë objektet e ekspozuara nga zjarret , largësitë e tyre nga qendrat e banuara pikat e vrojtim sinjalizimit , rrugët për lëvizjen e mjeteve. Kjo Hartë do të bëhet publike në të gjitha NJ.A. të cilat kanë zonë pyjore të rrezikuar, shkollat si edhe ambiente të tjera publike. Kjo hartë do ti vihet në dispozicion edhe Emergjencave Civile dhe MZSH. Afati i realizimit: maj 2026.

- Bashkia Maliq nëpërmjet Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave do të realizojë aktmarrëveshjet me vrojtuesit / sinjalizuesit në parandalimin edhe mbrojtjen e pyjeve/kullotave nga zjarret. Afati i realizimit: maj 2026.

- Punonjësit e Sektorit të Pyjeve / Teknikët e pyjeve dhe Inspektorët detyrohen të mbajnë takime me Administratorët e NJ.A. , komunitetin , barinjtë në kullota , subjekte të tjera që veprojnë në mjedisin pyjor /kullosor më qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e pyjeve/kullotave si edhe parandalimin e rënies së zjarreve. Afati i realizimit: gjatë gjithë vitit.

- Të gjitha strukturat e Sektorit të pyjeve/Kullotave gjatë periudhës së emergjencës (maj -tetor) të kenë të njohura në çdo moment lëvizjet e punonjësve . Për çdo lëvizje të lihet numri i telefonit celular dhe familjar. Afati i realizimit maj-tetor.

- Vrojtues/sinjalizues, Teknikët e Shërbimit pyjor dhe Inspektorët gjatë periudhës së emergjencës (maj -tetor) do të njoftojnë në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave , 2 herë në ditë ora 8.00 dhe 20.00 mbi situatën në zonën e tyre. Për këto njoftime do të mbahet Libri i Gatishmërisë. Afati i realizimit maj-tetor.

- Sektori i Pyjeve dhe Kullotave çdo të hënë dorëzon pranë Bashkisë Maliq evidencën operative të situatës javore. Afati i realizimit maj-tetor.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026

- Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore , vrojtuesi/sinjalizuesi kryen veprimet si më poshtë:

1. Njofton menjëherë në numrin e **telefonit 128 Shërbimin Zjarrfikës** dhe **129 të Policisë së Shtetit** ku prezanton veten me emër e mbiemër, tregon se ku jeni (vendndodhjen e saktë), tregon vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orientuese të sakta, me emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte te njohura), tregon llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar, etj.).

2. Njofton Eprorin e Strukturës dhe Administratorin e NJ.A. dhe jep informacion se ku ndodhet vatra e zjarrit.

3. Nëse evidentohen persona apo automjete në afërsi të vatrës së zjarrit dhe krijohen dyshime se zjarri mund të jetë i qëllimshëm mbahet shënim informacioni përkatës si lloji i automjetit, targa, përshkrimi i personit, etj.

4. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëherë ndërhyni, në të kundërt largohuni në një distancë te sigurt.

5. Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore , dhe marrjen e njoftimit nga vrojtuesi/sinjalizuesi , Administratori i NJ.A. , kryen veprimet si më poshtë:

6. Njofton Kryetarin e Bashkisë në pozicionin e Kryetarit të Shtabit .

7. Njofton shtabin për shuarjen e zjarreve për organizimin e skuadrave dhe ndërhyrjen në kohë sa më të shpejtë për vënien në kontroll të zjarrit.

8. Njofton Strukturën "Njësitë Vullnetare për shuarje Zjarri" e cila është ngritur dhe funksionon pranë NJ.A. në fjalë.

9. Të gjithë bashkë, organizohen për shuarjen e zjarrit ose lokalizimin e tij deri në mbërritjen e forcave të specializuar të mbrojtjes nga zjarri.

10. Me marrjen e informacionit për një rast zjarri Tekniku i zonës mban procesverbal kostatimi ose model informacioni për rënien e zjarrit duka mbajtur shënim të gjithë informacionin e nevojshëm si kohën kur ka rënë zjarri, vendin ku ka rënë, ekonominë pyjore dhe ngastrën, dhe nëse është mundësia logjistike koordinata dhe fotografi.

11. Në momentin e shuarjes së zjarrit të gjithë punonjësit e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave mbajnë procesverbalin e shuarjes së zjarrit sipas modelit përkatës duke plotësuar të gjitha rubrikat e procesverbalit.

12. Me procesverbalin e shuarjes së zjarrit specialisti i kadastrës në sektorin e pyjeve plotëson evidencën e zjarreve dhe e përcjell këtë informacion në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026


EP MESMAL
(KO 47 00)
EP STRELCË
(KO 65 00)
EP PIRG-MOCAN
(KO 54 00)
EP ZËMBLAK-MALI I
THATË (KO 70 00)
EP MOGLICË
(KO 48 00)
EP MALIQ-LOZHAN
(KO 44 00)
EP BOFJE E
DUSHARIT
(KO 30 00)

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë
Tel. 0861 2 2026

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

SKEMA E LAJMERIMIT NGA PERSONELI PYJOR NË RAST ZJARRI NË PYJE DHE KULLOTA



Kontakt i Emergjencave Civile
TEL: 128
CEL.0698163651
CEL.0692669950
CEL.0675529928
CEL.0692585559

- Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi mblidhet në çdo kohë që shihet e arsyeshme nga Kryetari i saj. Në këto mbledhje do të analizojë gjendjen dhe do të përcaktojë masat në vijueshmëri në përputhje me situatat që mund të krijohen. Përgatit dhe publikon komunikatën dhe informacione të tjera të nevojshme në funksion të situatës për punën e bërë në mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga zjarret.

- Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në rastet e " zjarreve masive" apo " zjarreve me përmasa të mëdha" sipas situatës që krijohet , i kërkon Institucionit të Prefektit në pozicionin e kryetarit të Shtabit qendror ndihmë për përballimin e situatës.

- Të gjitha strukturat e Bashkisë të cilat janë pjesë e këtij Plani Masash , duhet të përgatitin Programin e Detajuar për marrjen e masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri. Afati i realizimit maj 2026.

Ky program masash është hartuar sipas manualit për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Përgatiti :

Përgjegjës Sektori
Sektori i Pyjeve / Kullota

Klarsen Brako

Specialist Ing. Pyjesh
Sektori i Pyje / Kullota

Petrika Theodhosi

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. 0861 2 2026